Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/797

Datë:15.12.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, nenit 22 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Kërkesës së institucionit "PBC ACADEMY" për aprovim të ndryshimit të emrit të institucionit, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, Nenit 5 paragrafet 4, 5, 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2023 nxjerr këtë:

## V E N D I M

I. **Ndryshohet** vendimi Nr.01/453 i datës 26.07.2023, me të cilin është riakredituar institucioni "PBC ACADEMY", me adresë: rr. Tirana nr.91 në Prishtinë për periudhën tre (3) vjeçare përkatësisht nga data 01.10.2022 deri 30.09.2025, me kualifikimin e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

II. Vendimi si në paragrafin 1, ndryshohet sa i përket emërtimit të institucionit dhe nga emërtimi tregtar **"PBC ACADEMY"** ndryshohet në **"British College of Sciences".**

III. Pjesa tjetër e vendimit 01/453 të datës 27.07.2023 mbetet e pandryshuar.

IV. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Institucioni "PBC ACADEMY" ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim të institucionit. AKK ka zhvilluar procesin e vlerësimit me ekspert dhe bazuar në rekomandimet e ekipit të ekspertëve në raportet përfundimtare, Këshilli Drejtues i AKK-së ka nxjerrë vendimin nr. 01/453 të datës 26.07.2023 me të cilin institucioni "PBC ACADEMY" është riakredituar për periudhë tre (3) vjeçare nga data 01.10.2023 deri 30.09.2025 me kualifikimin Zhvillues Softueri, niveli V sipas KKK. Tutje, institucioni përmes email-it zyrtar ka njoftuar Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve

se në certifikatën e regjistrimit të biznesit ka ndryshuar emrin tregtar të institucionit dhe tani nga "PBC ACADEMY" ka marrë emrin e ri tregtar "British College of Sciences", po ashtu kanë kërkuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve t`i aprovohet kërkesa për ndryshim të emrit tregtar të institucionit duke theksuar faktin se certifikatat dhe diplomat për studentët/kandidatët do t`i lëshojnë me emrin e ri të institucionit dhe kanë kërkuar që ky ndryshim të aprovohet.

AKK ka proceduar këtë njoftim për shqyrtim në mbledhjen e KD të AKK-së të mbajtur me datë 30.11.2023.

Këshilli Drejtues i AKK-së pas shqyrtimit të njoftimit/kërkesës së institucionit për ndryshim të emërit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi i dërgohet:

- Institucionit "British College of Sciences"
- Arkivit të AKK- së

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar i KD të AKK-së